



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, nenit 17, shkronja **b**, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.3, nenit 17, paragrafët 1, 7, 8 dhe 9, nenit 26 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 04/L-174, korrik 2013), Udhëzimit administrativ nr. 41, 02/05, për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor mbi elemente themelore të planit rregullues, nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 19.05.2017, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM**  
**"KODRA E TRIMAVE 1" 2017-2025**

**Neni 1**

**Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor**

Miratohet Propozimvendimi i Planit rregullues të hollësishëm, lagjja "Kodra e Trimave 1" 2017 - 2025.

**Neni 2**

**Konsultimet publike**

Miratimi i Planit të cekur në pikën I të këtij vendimi, bëhet pas periudhës së shqyrtimit publik, raportit, analizës dhe inkorporimit të propozimeve të dala nga shqyrtimi publik

**Neni 3**

**Qëllimi i hartimit**

Në bazë të Planit rregullues të hollësishëm nga pika I e këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimi i tyre me

nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Prishtinës.

#### **Neni 4 Përmbajtja**

Plani rregullues i hollësishëm nga pika I e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

#### **Neni 5 Kufiri i territorit**

Territori i Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" 2017-2025, ka sipërfaqe prej 340 ha. Ky plan në pjesën veriore kufizohet me Unazën e brendshme, përkatësisht me lagjen "Bërnice e Poshtme", në pjesën lindore me lagjen "Kodra e Trimave 2", në pjesën jugore me lagjen "Tophane" dhe në perëndim me lagjen "Arbëria".

#### **Neni 6 Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim**

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë siguruar nga buxheti i Komunës së Prishtinës, në bazë të kontratës së lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe NNSH "A Design" - Prishtinë, me numër identifikues 616 12 105 221, dt. 21.11.2012, kontraktorit të përzgjedhur nga konkursi i projektimit sipas Ligjit nr. 03/L-241, për prokurim publik në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 7 Afati i vlefshmërisë**

Plani rregullues i hollësishëm mbulon periudhën së paku 8-vjeçare.

#### **Neni 8 Gjuha zyrtare**

Plani rregullues i hollësishëm sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.



**Neni 9**  
**Organet për zbatim**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Organet e tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Plani nga përgjegjësitë e tyre, të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-350/05-0118238/17, më 22.05.2017**



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**

**A R S Y E T I M I**  
**VENDIMIT PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM**  
**"KODRA E TRIMAVE 1" NË PRISHTINË**

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-035-1018, dt. 16.07.2008, ka filluar hartimi i Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" në Prishtinë.

Bazuar në këtë Vendim, në Ligjin për planifikim hapësinor nr. 2003/14, dt. 03.07.2003 dhe në Udhëzimin administrativ mbi elementet themelore të Planit rregullues urban, nr. 41, dt. 04.03.2005, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, ka përgatitur detyrën projektuese për hartimin e këtij niveli të planifikimit, në bazë të së cilës është shpallur tenderi dhe është zgjedhur ofertuesi për hartimin e Planit rregullues urban "Kodra e Trimave 1" në Prishtinë.

Sipas detyrave projektuese të hartuara nga Drejtoria, Departamenti i Prokurimit ka publikuar ofertat për zgjedhjen e kompanisë projektuese dhe pas përfundimit të këtyre procedurave konkurruese është përzgjedhur NNSH "A Design"- Prishtinë, kompani fituese për hartimin e këtij plani. Mbi këtë bazë është nënshkruar kontrata, me numër identifikues 616 12 105 221, dt. 21.11.2012, ku janë përcaktuar detyrat, kushtet, si afatet për hartimin e Planit rregullues në mes të kompanisë përfituese "A Design", me drejtor Bujar Demjaha, dhe Komunës së Prishtinës.

Për hartimin e këtij plani, komfor dispozitat ligjore, gjatë takimeve dhe punëtorive përveç përfaqësuesve të kompanisë projektuese, është angazhuar dhe ka dhënë kontribut edhe stafi profesional nga DUNMM.

Gjatë punës për hartimin e këtij Plani, kompania hartuese fillimisht ka dorëzuar planin dinamik për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1", në përputhje me afatin ligjor të paraparë me kontratën e lartshënuar, si në vazhdim:

**Faza e parë:**

- I. Incizimi gjeodezik;
- II. Identifikimi i informatave që duhet grumbulluar;
- III. Analiza e pjesëmarrësve;
- IV. Përgatitja e profilit urban;
- V. Vlerësimi i situatës në lokacion;
- VI. Konsultimet për procesin e planifikimit.

**Faza e dytë:**

- I. Opsionet e zhvillimit;
- II. Prezantimi i zgjidhjeve të mundshme, konkretisht tre skenarë;
- III. Hartimi i Planit rregullues.



Pasi përfundimit të fazës së dytë, kompania hartuese e kontraktuar, së bashku me ekspertët e DUNMM-së dhe stafin mbikëqyrës të kësaj kontrate, në vazhdimësi vijuan procedurat e tjera të radhës të parapara sipas Ligjit, me përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, duke përcjellë këtë material të dorëzuar te Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm dhe instancat tjera për shqyrtim dhe miratim.

#### Faza e tretë:

##### I. Diskutimi, shqyrtimi publik dhe miratimi i planit.

Kompania hartuese e lartcekur ka vazhduar me punën e mëtutjeshme rreth hartimit të këtij plani. Gjatë kësaj periudhe, përkatësisht fazës së parë dhe të dytë, janë mbajtur takime profesionale.

Procedura për hartimin e Planit rregullues "Kodra e Trimave 1" ishte pezulluar nga ana e MMPH-së, me njoftimin e dt. 29.11.2013, për shkak të Ligjit të ri të planifikimit dhe akteve nënligjore të cilat duhet të nxirreshin. Për këtë arsye është zgjatur afati i dorëzimit të materialit.

Kompania hartuese ka dorëzuar materialin (pjesën tekstuale dhe grafike), gjegjësisht këtë propozimplan në Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për ta përcjellë këtë material në Bordin e Drejtorëve, Komitetin për Planifikim dhe Urbanizëm. Materiali është dorëzuar në tri kopje të forta dhe 10 kopje elektronike (CD).

Më 04.10.2016, nga Kuvendi i Komunës është miratuar Vendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" për grupet e interesit, departamenteve, agjencive dhe organeve të tjera për shqyrtim, komente e propozime të tjera profesionale, nga dt. 30.05.2016 deri më 30.06.2016.

Bazuar në Vendimin 01-031 -28460, dt. 24.12.2014 dhe Vendimin 10-031-88112, dt. 23.04.2015 të Kryetarit të Komunës, formohet komisioni për shqyrtimin e vërejtjeve, komenteve propozimeve dhe sugjerimeve të paraqitura nga qytetarët dhe grupet tjera të interesit, ku bëjnë pjesës edhe ato të ekspertëve, gjatë shqyrtimit publik.

Komisioni profesional ishte në këtë përbërje:

1. Florim Krasniqi, arch., kryesues;
2. Mimoza Prestreshi, arch., anëtare;
3. Lydra Hoxha, arch., anëtare;
4. Makfired Abdullahu, inxh. i kom., anëtar;
5. Ms. Jehona Mavraj, ekologe, anëtare.

Komisioni ka filluar punën më 19.12.2016, për të shqyrtuar vërejtjet dhe propozimet e qytetarëve dhe të grupeve të interesit të paraqitura gjatë shqyrtimit publik.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur takime profesionale, ku kanë marrë pjesë edhe ekspertë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës, ku me sugjerimet e tyre kanë dhënë kontribut të çmuar, si dhe grupi menaxherial – mbikëqyrës për të gjitha fazat e planit rregullues.

Pas shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura nga publiku, më 04.04.2017, komisioni ka përfunduar dhe dorëzuar raportin, kështu që kompania projektuese ka përfunduar plotësimet dhe ndryshimet e planit sipas rekomandimeve të komisionit profesional.

Bazuar në të gjitha konstatime që u thanë më lart, Plani rregullues i hollësishëm “Kodra e Trimave 1” është i gatshëm të dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Menaxher: Hazir Zhitija, inxh. dipl. ark.  
Mbikëqyrësit sipas fazave: Zana Ismajli, inxh. dipl. ark,  
Msc. Ferit Fazliu, inxh. i dipl. ndërt.  
Makfired Abdullahu, msc. kom.  
Merita Rushiti, inxh. dipl. ndërt.  
Avdurrahman Krasniqi, inxh. i dipl. elek.  
Daut Humolli, inxh. i dipl. mak.  
Krenare Shkodra, msc. arch.